

VENDIM
Nr. 149, datë 28.6.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“DON – UCD” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 475, datë 27.6.2018, shoqëria “DON – UCD” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “DON – UCB” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
- dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar) do t’i kërkohej subjektit që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, që t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “DON – UCD” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti